



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË**

Shpallja e procedurës së aplikimit për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm) për vitin akademik 2026 – 2027.

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, shpall procedurën e aplikimit për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm) për vitin akademik 2026 – 2027, për:

Departamenti Ekonomiks

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
2. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një veprë penale me dashje.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të zotërojnë së paku diplomën në Master i Shkencave ose DIND në Fakultetin e Ekonomisë UT, në fushën e Ekonomiksit ose në fusha të ngjashme me to në Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit (me diploma të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit), me rezultate të larta, preferohen të kenë gradën shkencore “Doktor”.
2. Preferohen të kenë eksperiencë në mësimdhënie pranë Fakultetit të Ekonomisë UT.
3. Të zotërojnë me dëshmi një gjuhë të huaj, të vendeve të BE-së.
4. Preferohen aplikantët që kanë aftësi të mira komunikuese.

Departamenti Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
2. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një vepr penale me dashje.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të zotërojnë, së paku, diplomën Master i Shkencave (MSc) ose DIND, të fituar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës ose në fusha të përafërta dhe të lidhura me to, në universitete të tjera, brenda ose jashtë vendit, me rezultate të mira akademike.
2. Të kenë, preferencialisht, eksperiencë të mëparshme në mësimdhënie pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.
3. Të kenë ekspertizë akademike dhe/ose profesionale në një ose më shumë nënfusha të Matematikës, Statistikës dhe Informatikës, në përputhje me nevojat mësimore dhe disiplinat e programeve të studimit të mbuluara nga Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.
4. Të zotërojnë, të dokumentuar me dëshmi përkatëse, një gjuhë të huaj të një prej vendeve të Bashkimit Evropian.
5. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunuese, si dhe aftësi për të zhvilluar në mënyrë efektive procesin e mësimdhënies në arsimin e lartë.

Departamenti Manaxhim

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të zotërojnë së paku diplomën Master i Shkencave (MSc) ose diplomën DIND, në fushën e ekonomisë, të fituar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës (UT), ose në fakultete të ngjashme të një Institucioni të Arsimit të Lartë (IAL), brenda ose jashtë vendit, të njohur nga MAS. Përbën përparësi formimi akademik në nënfushën e Manaxhimit.
2. Të ketë përfunduar studimet universitare me rezultate të lartë në çdo nivel studimi, përfshirë Bachelor dhe Master i Shkencave/DIND.
3. Të zotërojnë, të paktën, një gjuhë të huaj të një prej vendeve të Bashkimit Evropian, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës.
4. Të zotërojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Publikimet në revista shkencore, pjesmarrja në konferenca dhe angazhimi në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore në fushën e ekonomisë përbëjnë përparësi.
2. Kualifikimet dhe /ose trajnimet e vazhdueshme profesionale, të lidhura me fushën e ekonomisë, manaxhimit dhe / ose mësimdhënies, përbëjnë përparësi.
3. Eksperienca në mësimdhënie në fushat që mbulon Departamenti i Menaxhimit përbën përparësi.
4. Zotërimi i një gjuhe të dytë të huaj të vendeve të Bashkimit Evropian, i vërtetuar me dokumentacionin përkatës, përbën përparësi.

Departamenti Financë

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të jenë diplomuar në Master i Shkencave në Fakultetin e Ekonomisë të UT-së ose në Fakultetet Ekonomike në Universitete publike të vendit ose Universitete të njohura përëndimore në Degën Financë (me diploma të ekuivalentuara).
2. Të kenë përfunduar studimet universitare të secilit cikël me notë mesatare mbi 8.
3. Të njohin mirë gjuhë të huaj të provuar me dëshmi.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata.
5. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të jenë diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, si dhe në Universitetet Perëndimore në Bachelor dhe/ose Master dhe/ose Doktoraturë në fushën e Financës.
2. Të kenë eksperience pune në fushat që mbulon Departamenti i Financës. Preferohen aplikantët me eksperiencë pune në institucione kërkimore-shkencore publike apo private.
3. Të kenë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore.
4. Të kenë eksperience pedagogjike të mësimdhënies në fushën e Financë-Kontabilitet, preferohen në Fakultetin e Ekonomisë të UT.
5. Të kenë të mbrojtur me dëshmi në gjuhën angleze.

Departamentin Kontabilitet

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
2. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një vepre penale me dashje.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të zotërojnë së paku diplomën në Master i Shkencave ose DIND në Fakultetin e Ekonomisë UT, ose në fusha të ngjashme me to në Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, me rezultate të larta.
2. Të zotërojnë me dëshmi një gjuhë të huaj, të vendeve të BE-së.
3. Preferohen të kenë eksperiencë në mësimdhënie pranë Fakultetit të Ekonomisë UT OSE Në Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.
4. Preferohet të ketë përvojë në mësimdhënie në lëndët e fushat që mbulon Departamenti i Kontabilitetit dhe për të cilat ai ka nevojë.
5. Preferohet të ketë ushtruar veprimtari kërkimore-shkencore të identifikuara këto me artikuj shkencor apo referime të mbajtura në veprimtari shkencore, brenda ose jashtë vendit.
6. Të jetë komunikues, motivues dhe i dedikuar.
7. Të ketë njohuri shumë të mira kompjuterike dhe veçanarisht në fushën e kontabilitetit, të vërtetuara me dëshmi të njohura (njësi ekonomike të licensuara, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, R.SH: ose jashtë vendit).

Departamentin Marketing – Turizëm.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
2. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një vepre penale me dashje.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të zotërojnë së paku diplomën Master i Shkencave ose DIND në Fakultetin e Ekonomisë UT, ose në fusha të ngjashme me to, në Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, me rezultate të larta.
2. Preferohen të kenë eksperiencë në mësimdhënie pranë Fakultetit të Ekonomisë UT.
3. Të zotërojnë me dëshmi një gjuhë të huaj, të vendeve të BE-së.
4. Preferohen aplikantët që kanë aftësi të mira komunikuese.

Kandidatët konkurrentë duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

- Kërkesë për aplikim.
- Curriculum Vitae e përditësuar (në gjuhën zyrtare shqip).
- Fotokopje e dokumentit të identitetit (kartë identiteti ose pasaportë).
- Diplomë e studimeve universitare Bachelor dhe Master i Shkencave. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet dokumenti i njohjes së diplomës të njehsuar me origjinalin.
- Listë notash Bachelor dhe Master i Shkencave. Dokumenti i njohjes së listës së notave për ata që kanë mbaruar në universitetet e huaja.
- Dokumenti i laureimit me gradë apo titull akademik. Dokumenti i njohjes së gradës apo titullit akademik.
- Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj.
- Çertifikatë personale.
- Vertetim nga qendra e punës e muajit të fundit.
- Dëshmi penaliteti.
- Libreza shëndetësore.
- Raport për aftësi në punë.

Dokumentacioni dorëzohet pranë departamentit përkatës ku do të aplikohet, në Fakultetin e Ekonomisë Universiteti i Tiranës. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri në datën **25.09.2026, ora 14.00.**